



Mirësevini në Buletin e 3-të Informativ të projektit EnerNETMob - Interreg MED!

EnerNETMob highlights

E ardhmja e Elektromobilitetit në Itali: Intervistë me Giovanni Carlo Cancelleri, Zëvendësministri Italian për Infrastrukturën dhe Transportin.

Përhapja e mobilitetit elektrik në Itali sot has vështirësi nga një seri kufizimesh strukturore që lidhen në veçanti me numrin e kufizuar të pikave të karikimit në territorin kombëtar, në rang bashkie por edhe përgjatë autostradave, veçanërisht krahasuar me shtetet e tjera. Kjo ndikon në mënyrë të pashmangshme në qëndrueshmërinë e sistemit të transportit, duke theksuar nevojën për mbështetjen e mobilitetit elektrik në një linjë me udhëzimet e BE-së nëpërmjet politikave efektive të investimit.

Në intervistuar Giovanni Carlo Cancelleri, Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Transportit, se cilat janë udhëzimet strategjike të qeverisë italiane për të mbështetur zhvillimin e elektromobilitetit në mbështetje të disa sektorëve ekonomikë, duke përfshirë agro-ushqimin.

Lexoni intervistën e plotë këtu!

Takimi i stafit të EnerNETMob me Drejtorin e Sekretariatit të Traktatit të Komunitetit të Transportit

Më 16 tetor, Z. Matej Zakonjšek, Drejtor i Sekretariatit të Përhershëm të Traktatit të Komunitetit të Transportit dhe përfaqësues të Ministrisë së Transportit dhe Çështjeve Detare të Malit të Zi vizituan Portin e Barit. Traktati i Komunitetit të Transportit është një organizatë ndërkombëtare në fushën e mobilitetit dhe transportit, me 33 pjesëmarrës - të gjithë shtetet e BE-së dhe 6 partnerë rajonalë nga Ballkani Perëndimor.

Temat kryesore të takimit kishin të bënin me zhvillimin e sektorit të transportit multimodal dhe atij detar, lidhjen e portit me zonat e thella të vendit, dekarbonizimi dhe digjitalizimi. Kjo vizitë u shfrytëzua si një mundësi për të prezantuar projektin EnerNETMob dhe objektivat e tij në promovimin e strategjisë së karbon të ulët përfshirë mobilitetin urban multimodal dhe masat përkatëse, si dhe për të testuar një makine elektrike të blerë me fondet e projektit.

Lexoni më shumë këtu!

Përditësimë mbi zbatimin e projekteve pilot



Makinat elektrike dhe pikat e karikimit në Rajonin e Peloponezisë, Greqi

Rajoni i Peloponezisë, partneri udhëheqës në projektin EnerNETMob, ka bërë një hap të madh drejt elektromobilitetit në 6 muajt e fundit. Më konkretisht, 6 makina plotësisht elektrike (5 Nissan Leaf dhe 1 BMW i3) i janë shtuar flotës së tij, të blera me fondet e projektit EnerNETMob si edhe nga fondet e veta apo fonde europiane. 5 makina të tjera plotësisht elektrike do të blihen brenda gjysmës së parë të vitit 2021, duke rritur numrin e makinave me emetim-zero në 11, si edhe duke zvogëluar në mënyrë drastike kostot e udhëtimit të drejtuesve dhe nëpunësve të Rajonit. Gjithashtu është ngritur një rrjet i pikave të karikimit të makinave elektrike. Në veçanti, projekti EnerNETMob mundësoi instalimin e 4 stacioneve të karikimit në Kalamata, Sparta, Nafplio dhe Loutraki, secili me nga 2 pika karikimi. Këto stacione karikimi i janë shtuar hapësirës ekzistuese publike, duke mundësuar kështu zgjerimin e infrastrukturës së karikimit, dhe duke u dhënë shembullin institucioneve dhe qytetarëve të Rajonit të Peloponezisë mbi rritjen e transportit elektrik.

Lexoni më shumë këtu!



Njësia demonstruese e e-mobilitetit për logjistikën urbane në rajonin e Francës Jugore

Duke kontribuar në nxitjen e elektro-mobilitetit kombinuar me përdorimin e energjive të rinovueshme, Capenergies dhe partnerët lokalë në rajonin e Francës Jugore, janë gati të lançojnë në prill 2021 njësinë demonstruese EnerNETMob të e-mobilitetit specifikisht për logjistikën në sektorin agro-ushqimor, nëpërmjet një stacioni karikimi fotovoltaik, 2 pika karikimi dhe një makinë elektrike tregtare që kryen dërgesa të rregullta qytet-qendër. Njësia demonstruese EnerNETMob do të mundësojë të dhëna të reja mbi optimizimin e karikimit nëpërmjet energjisë diellore dhe përdorimin e makinave. Këto rezultate do të sigurojnë informacione të vlefshme për planet e veprimit të mobilitetit që po zbatohen aktualisht nga autoritetet lokale.

Lexoni më shumë këtu!

Takimet dhe eventet EnerNETMob



Forumi Energjia për Mobilitetin Smart: edicioni i 3-të i suksesshëm 100% digjital

Afërsisht 300 palë interesi nga sektori i energjisë dhe mobilitetit u mblodhën në platformën E4SM gjatë 2 ditëve për një eksperiencë digjitale të nivelit të lartë! 120 takime biznesi, 3 konferenca dhe 11 seminare mbi sfidat e mobilitetit të qëndrueshëm! 5 trende kryesore rezultuan nga ky edicion i 3-të i forumit E4SM:

- Përdhëpajtimi i përhapjes së infrastrukturës
- Të dhënat po rriten në vlerë
- Rritja e përdorimit të hidrogjenit
- Ulja e impaktit të transportit detar në mjedis
- Zhvillimi i modeleve të biznesit

Lexoni më shumë këtu!



Projekti EnerNETMob në Forumin "Circle the MED 2020"

EnerNETMob së bashku me Komunitetin e Transportit Urban bashkë-organizuan dy sesione në kuadër të Forumit "Circle the MED". Sesioni i parë "Tranzicioni i qyteteve Mesdhetare drejt mobilitetit të qëndrueshëm dhe smart" ishte një diskutim i fokusuar tek drejtuesit e mjeteve, barrierat që mundësitë për sektorin nën prizmin e Marrëveshjes së Gjelbërt të BE & Europës gati për epokën digjitale. Sesioni mblodhi mbi 600 pjesëmarrës nga 16 shtete. Diskutimi u vijua me një sesion të dytë "Roli i qyteteve & rajoneve në vlerësimin e zgjidhjeve të elektromobilitetit në Mesdhe". 250 pjesëmarrës nga 12 shtete u bashkuan në këtë sesion, për të mësuar më shumë mbi përfitimet e kalimit në mobilitetin elektrik dhe rreth ekonomisë qarkulluese. Paneli përbëhej nga përfaqësues të institucioneve kërkimore-shkencore, institucione publike dhe SME. Lexoni më shumë për përfundimet e diskutimit këtu dhe për sesionin e dytë këtu!

"Elektromobiliteti: impakti i planifikimit urban në trendet e teknologjisë"

Në 25 nëntor 2020, EnerNETMob mori pjesë në webinar-in "Elektromobiliteti: impakti i trendeve teknologjike në planifikimin urban". Webinari u zhvillua në kuadër të serisë së webinarëve të Komunitetit të Transportit Urban "Implementimi i Mobilitetit të Qëndrueshëm në Mesdhe". Në këtë webinar specifik folësit prezantuan projektet dhe eksperiencat që tregojnë sesi elektromobiliteti në planifikimin urban është ngushtësisht i lidhur me sektorin energjitik.

Lexoni më shumë këtu!



Takimi i 6-të i projektit EnerNETMob

Takimi i 6-të i EnerNETMob u zhvillua online. Në takim morën pjesë të gjithë partnerët për të diskutuar mbi progresin e projektit dhe hapat e ardhshëm. Vëmendje e veçantë iu kushtua përshtatjes së aktiviteteve të projektit ndaj situatës Covid-19.

Bashkohu me rrjetin EnerNETMob

Projekti EnerNETMob numëron 16 partnerë nga 12 shtete Mesdhetare: Greqia, Malta, Italia, Qipro, Shqipëria, Slovenia, Portugalia, Mali i Zi, Spanja, Franca dhe Austria, të cilët po drejtojnë rritjen e zgjidhjeve të elektromobilitetit në rajonin e Mesdheut. Bashkohu me rrjetin tonë!

Facebook: @enernetmob
 Twitter: @EnerNETMob

Mësoni më shumë mbi projektin EnerNETMob: enernetmob.interreg-med.eu

THE ENERNETMOB PARTNERSHIP

- Region of Peloponnese-Department of Management for Development Planning, (LP)
- Regional Development Agency of Northern Primorska Ltd. Nova Gorica
- Authority of transport in Malta
- Free Municipal Consortium of Ragusa
- RAM Logistica Infrastruttura e Trasporti s.p.a.
- Free Municipal Consortium of Athens
- Ministry of Transport, Communications and Works
- Port of Bar Holding company
- Albanian Institute of Transport
- CIMNE, International Center for numeric methods in engineering-Barcelona
- Region of Thessaly-Department of Development and Planning
- CAPENERGIES, Aix-en-Provence, France
- County of Primorje and Gorski Kotar
- FORSCHUNGSGES ELLSCHAFT MOBILITÄT - Austrian Mobility Research FGM - AMOR
- University of Palermo- Department of Agricultural, Food and Forest Sciences